

Agamemnoni



*(Edhe një herë, nga kreu i shkallëve të mermerta, që janë shtruar deri në fund me tapet të purpurt, kryekomandanti përsbëndet turmën brohoritëse, me një gjest padurimi pothuaj. Nga sheshi që ndodhet ca më poshtë, nën diellin e kristaltë të dimrit, dëgjohen gjësimet e tambureve, vringëllimat e potkonjve të kuajve, valëvitjet e flamurëve dhe zërat e sklleverve që shkarkojnë trofetë nga karrot. Vetëm rojet qëndrojnë pa lëvizur asnjë grimë nëpër portikë, sikur i përkasin një bote tjetër. Nëpër ajër valëzon kundërmimi i athët i dafinave të shkelura me këmbë. Mes thirrjeve dhe poteres së përgjithshme, spikatin një e më dy profecitë e një gruaje të çartur që është shembur përfund shkallëve - fjalë të pakuptueshme, në gjubë të huaj. Kryekomandanti me të shoqen u larguan. Kaluan nëpër korridorin e gjatë. Janë duke hyrë në sallën ku është shtruar tryeza e sillës. Ai po zhvesh uniformën e luftëtarit. Përkrenaren e madhe me bisht kali e vendos mbi komo, para pasqyrës. Shëmbëllimi i saj shfaqet në pasqyrë dhe ngjet sikur dy përkrenare të shformuara prej hekuri i bëjnë shoqëri njëra-tjetrës. Ulet në një kolltuk. Mbyll sytë. Nga jashtë, vazhdojnë të vijnë brohorimat e turmës dhe klithmat e gruas së huaj. Ai i zë veshët me të dyja duart. E shoqja, e bukur, e rreptë, hijerëndë, përkulet dhe i zbërthen sandalet, gjest ky që bie ndesh me çehren e saj. Ai i vendos dorën e majtë mbi flokë, me kujdes, që të mos i prishë krehjen e bukur. Ajo zmbrapset. Qëndron drejt në këmbë, ca më tutje. Atij i përvijohet në fytyrë një buzagaz i largët, i lodhur. I flet. Nuk dihet nëse ajo e dëgjon.)*

Jepu urdhër, të përgjërohem, që të heshtin. Ç'brohorasin më?  
Për kë duartrokasit? Kë lëvdojnë? Mos xhelatët e tyre? Apo të afërmit që humbën?  
A mos vallë, duke i përplasur pas shoshoqes, të binden që kanë ende duar,  
që kanë ende zë, ndaj dhe thërrasin, për ta dëgjuar vetë?  
Thuaju të heshtin. Shiko, një milingonë po zbret murin -  
me ç'siguri e thjeshtësi çapitet nëpër atë pingule,  
pa kurrfarë krekosjeje, me vetëdijen se nuk po kryen ndonjë bëmë të madhe - mbase ngaqë është e  
vetme,  
mbase ngaqë është e parëndësishme, e papeshë, e paqenë pothuaj; - ia lakmoj fatin.

Lëre; mos e nga; po ngjitet mbi tryezë; mori një thërrime;  
më e rëndë barra sesa ajo vetë; - shikoje, - përherë  
barra që ngremë të gjithë ne, më e rëndë se shtati ynë.

Nuk paskan ndër mend të heshtin. Dhe zjarret nëpër tempuj - ky tym  
dhe kjo erë mishi të pjekur; - më përzihet, - jo nga stuhia që kaluam në det -  
kam një hidhësi në gojë, një frikë

në gishta, në lëkurë; - si atëherë, një natë vere,  
që brofa në gjumë - diç veshtullore më zvarritej nëpër trup;  
nuk e gjeja shkrepësen; diku u pengova; ndeza bishtukun:  
në shatorre, përdhe, nëpër çarçafë, mbi shqyt, mbi përkrenare,  
me mijëra ligavecë; i shkelja zbathur; dola jashtë - kishte pakëz hënë,  
ushtarët, lakuriq, u kishin hapur luftë, duke qeshur, duke u tallur,  
atyre zvarranikëve të neveritshëm - të neveritshëm edhe vetë ata; plaçkat  
u tundeshin si ligavecë. U hodha në det; uji nuk më lante;  
mollëzës së majtë më zvarritej hëna, veshtullore edhe ajo,  
lëng i verdhë, i verdhë edhe i trashë. Edhe tani këto brohoritje -

Gatitmë një banjë të nxehtë, shumë të nxehtë; - e paske gatitur?  
Me gjethe shqindi dhe mërsine? U mbaj mend kundërmimin  
e mprehtë, që më përtërinte të tërin - një mërgim; si të nuhatësh sërish  
fëmijërinë, me pemë, me lumenj, me gjinkalla. Vajzat  
m'u dukën si të përhumura; - i vure re? - njëra,  
mu si e verbër, më kërkonte nëpër mjekër nofullën. Bëre mirë  
që i dërgove nëpër dhoma, - nuk i shikojta dot ashtu.

Gjithë trofetë mbajini, ndajini me shoshoqe - unë nuk dua gjë.  
Kurse atë gruan që këlthet nëpër shkallë, mbaje skllave  
a mëndeshë të djalit (- vërtet, ku është? - nuk e pashë) - jo në shtratin tim, jo,  
tani e dua gjithë shtratin për vete, të zhytem, të humbas, të jem,  
të paktën në gjumë të mos vrojtohem, të mos vras mendje  
në e kam fytyrën sa duhet të rreptë a në m'u shtendosën  
muskujt e barkut dhe të krahëve. Tani  
vetëm kujtesa e epshit ngjall epsh, duke fshirë  
atë shpërpjesëtimin e madh, të pavend, midis  
vyshkjes së trupit dhe kryeneçësisë së dëshirës.

Dhe, natyrisht, shtratin tonë po ta lë ty. Nuk do të dëshiroja aspak  
të bëhesha dëshmitar i gjurmëve të kohës mbi fytyrën tënde të bukur,  
nëpër kofshë e gjinj. Nuk kam ndonjë urrejtje për të ushqyer

me të tillë pamje. Madje, përkundrazi, do të doja  
ta ruaj të pacenuar (për hatrin tim - jo tëndin)  
shtatin tënd dashuror përtej kohës, si statujë të mrekullueshme,  
që edhe më mbron disi shkëlqimin dhe lavdinë e rinisë sime.

Vetëm atë taketuken me trekëmbëshin e gdhendur (në s'ka humbur),  
ku harroja dikur netëve cigaren të tymoste vetiu,  
porsi tymtar i largët në një Itakë të vogël a porsi një  
yll imi, ndërsa ti dremitje bri meje, do ta doja.

Të tjerat mbajini; edhe skeptrin e rëndë gjithë diamante -  
sidomos atë - nuk kam ç'e dua - mezi ngrihet. Sot ndiej  
zemërimin e Akilit, - jo, nuk ishte aspak hakmarrje ndaj meje - ishte lodhje,  
një lodhje pararendëse, që barazonte ngadhënjimin me humbjen,  
jetën me vdekjen. Fill i vetëm poshtë, në ranishtë,  
në shoqërinë e qenit të zi që iu bë pas në mënyrë të pashpjegueshme  
një natë vjeshte me hënë të madhe (kështu thoshin).

Mbase kishte edhe nevojë për atë prani memece,  
që nuk bën pyetje, nuk mohon, por beson e miraton ngaherë  
me një të tundur bishti, me një të pulitur qepallash  
a, ndonjëherë, duke mbështetur turinjte gjithë mirënjohje  
mbi sandalet e të zotit, duke pritur me të njëjtin ngazëllim  
ledhatimin apo shkelmin; a, tjetër herë, duke gulçuar, jo nga të vrapuarit,  
por nga përkushtimi, duke varur jashtë gjuhën e kuqe  
si të mbante mes dhëmbëve një copë të përgjakur nga shpirti i vet  
dhe sikur donte ta jepte. Një i tillë përkushtim, ma ha mendja,  
mund të shpëtojë një njeri a edhe një hyjni. Patrokli bëhej xheloz;

dhe mbase ndaj e nxiste të merrte pjesë përsëri në luftë  
dhe mbase ndaj edhe u vra. Sa gjak u derdh -  
nuk e mora vesh përse - nuk di gjë; - kishte raste që nuk guxoja  
të prekja bukën me dorë - buka ishte e kuqe. Dhe ai qeni që thashë,

si u vra Akili, vërtitej fillikat nëpër ranishtë,  
vështronte anijet, retë, nuhaste gurët,  
ku patën shkelur këmbët e të zot', nuhaste teshat në shatorre,  
i pangrënë, i uritur - e kush mund të kujdesej për të? - na pengonte,  
na ngatërrohej nëpër këmbë, disa e godisnin me shkelm; rrinte  
dhe shihte ushtarët teksa hanin; nuk kuiste.

Një ditë, dikush i hodhi një eshtër; s'e lëpiu;  
e mori mes dhëmbëve dhe u zhduk. Pas pak e gjetën  
te varri i Akilit, - ia kishte lënë eshtërën përsipër  
si një kushtim; dhe dëneste me lot të mëdhenj  
ndoshta për humbjen e të zotit, ndoshta edhe nga turpi pse kishte uri.  
Mandej e mori eshtërën prapë, u fsheh mbas gurëve  
dhe zuri ta brente. Tok me brejtjen e eshtërës  
dëgjoheshin edhe ngashërimet, - mbase ishin edhe ofshamat e urisë shekullore.

Sa të çuditshëm i paske sytë; edhe zërin të çuditshëm, kur the:  
“Skllave, ç'më rriin ashtu? Mos e harruat urdhrin që ju dhashë?  
Thashë të shtrohet rruga me tapet që nga koçia deri në shtëpi, të bëhet gjithë rruga  
e kuqe, që të kalojë imzot”. Kishte në zërin tënd  
një lumë të thellë dhe m'u duk sikur notoja nëpër të. Kur shkela  
sipër tapetit të purpurt, m'u këputën gjunjët. U ktheva  
dhe pashë gjurmët e mia me pluhurin e sandaleve mbi të kuqen e pafundme  
si ato tapat e peshkimit që notojnë  
mbi rrjetën e zhytur e të fshehtë. Dhe pashë para vetes skllavet  
tek shpëstullnin edhe të tjerë tapetë të kuq, sikur shtynin  
rrotat e kuqe të fatit. Një drithërimë  
më përshkoi ashtin. Ndaj të kërkova të më gatitje  
një banjë të nxehtë. Ajo drithërimë - prej qelqi, prej qelqi, - ti e di vetë,  
askush nuk dëshiron të vdesë, sado i lodhur qoftë.

Kjo lodhje që po më këput, është tashmë truallë im, jam unë; sikur i ngjitem,  
pa mund, pa këmbë pothuaj, malit të kaltërremë

nga do të sodit (dhe i sodit qysh tani) teposhtë  
kodra, fusha, qytete - pak tym prarohet në diell - portet  
dhe anijet e kthimit tonë të hidhur në gjysmërrethin  
e bregut të shkretë, - anije të bardha, të largëta, të zvogëluara  
si thonj të prerë fëmije - si të vajzës tjetër - të kujtohet? -  
që ia prisje te pragu i banjës; - nuk donte; bërtiste; - kanë shkuar kaq vite.

Si e lamë kohën e na vajti dëm, duke u përpjekur fare kot  
të siguronim një vend në sy të botës? Asnjë  
sekondë për veten, gjatë gjithë këtyre verërave, as për të kundruar  
hijen e një zogu sipër kallëzave - një trirremëshe të vogël  
nëpër detin e praruar; - me të mund të kishim vozitur  
për të kërkuar medalje të heshtura, fitore më të lavdishme. Nuk vozitëm.

Herë-herë, më duket sikur jam një i vdekur i qetë, që më vështron  
tek gjalloj; që ndjek me sy të zbrazët  
lëvizjet, gjetet e mia; - si atëherë, një natë dimri,  
aty poshtë, jashtë mureve, me një dritë hëne të papërshkrueshme, të ftohtë  
dhe ngjante gjithçka si e shndërruar në mermer, si e sajuar prej gëlqereje dhe hëne.

Vëzhgoja përreth me një shpërfillje prej të pavdekshmi, që tashmë  
vdekjes nuk i trembet dhe as e vret mendjen për pavdekësinë e vet. Po, si një  
i vdekur plot hijeshi, që shëtit nëpër bardhësinë e natës, duke vëzhguar  
stolitë prej allçie të shtëpive, kangjellat e kopshteve,  
hijet e direkëve në bregdet. Dhe atëherë, një shigjetë  
më fërshëlleu pranë veshit, u ngul mureve duke u përpëlitur  
si tel i vetëm i një instrumenti të panjohur, si një nerv  
në trupin e boshit, duke regëtirë me një ngazëllim të pakuptueshëm.  
Kështu ndodhte, atje tej, të na ndalte diçka - nuk dihej ç'ishte -  
shkëndija e agullimës përmbi shpatë, pasqyrimi  
i zvogëluar i një reje të qetë sipër një përkrenareje  
apo ai zakoni i Patroklit për të kapur me dy gishta  
majën e veshit, ndërsa nuk bënte zë, i zhytur në një ëndërrim

viran dashurie. Një ditë, Akili i kapi dorën, ia hetoi gishtat si orakull, pastaj i hetoi veshin. “Po afron vjeshta,- tha,- duhet të riorganizojmë forcat.” Dhe kishte një lidhje të çuditshme mes asaj “riorganizojmë” dhe gjestit të bukur të Patroklit.

Dhe atëherë Patrokli doli nga shatorrja, shkoi te kuajt e shokut, te Vaji dhe Ksanthi, qëndroi mes tyre, ua kaloi të dyja duart rreth qafave të holla dhe, kështu, të tre, me fytyrat ngjitur, ndenjën pa lëvizur duke kundruar perëndimin. Këtë pamje e kam hasur, më duket, në një reliev portiku dhe befasisht kuptova se ia vlen të flijosh një njeri për pakëz erë të mbarë.

Dalëngadalë u zhvesh gjithçka, u qetësua, u bë prej qelqi, muret, dyert, flokët, duart e tua - një qartësi e shkëlqyer prej qelqi - as duhja e vdekjes nuk e vagëllon dot; dallohet përtej qelqit i pandashëm hiçi - diçka më në fund e plotë - ajo plotësia e parë, e pacenueshme, si të mosqenit.

Pa e ulur dorën mbi dorezë, pa e shtyrë portën, pa hyrë ende në sallë, pashë kanapenë, karriget dhe pasqyrën ku duket muri përballë me tablonë e një beteje të stërlashtë detare. Pa hyrë ende në banjë, shoh gjethet e mërsinës tek notojnë në ujë dhe fytyrat e ënjtura të avujve tek ngjiten në tavan, tek shtyhen në baxhë. Gjer dhe orën e vdekjes sime e shquaj njëfarësoj.

Falma këtë largpamësi, sidomos që ta rrëfeva - kjo është një mënyrë që të më shihni edhe ju; të bëhemi të barabartë - sikundër dhe jemi - të gjithë, pra, të paarmatosur. Por, prapëseprapë, këtë çast, pyes veten e ç’do të fitoj, kujt t’i shmangem, ç’të fsheh me këtë rrëfim timin; - cila të jetë vallë maska e re prej qelqi të pathyeshëm mbi qelqin e brishtë të fytyrës sime - një maskë e madhe dhe e zbrazët, vazhdim i të prerave të mia, shprehja ime,



varur lart, para pallatit, në ballë të portikut,  
e vetmja emblemë, imja, jo e dinastisë. Ndonjëherë, kam përshtypjen  
se të gjitha ndodhën vetëm e vetëm që një ditë t'i kujtoj  
a, edhe më tepër, që të zbuloj kotësinë e tyre të pavdekshme.

Orë e mirë - dhe i gëzohem. Vështroj dorën -  
nuk është as për shpatë as për ledhatim; - e vetme, e lëshuar,  
- e lëshuar ku? - mbi ca korda të padukshme, porsi dora  
e rapsodit mbi një lirë të madhe; - po t'ia mbash një çast,  
muzika ndalet e habitur; dhe tingulli i pambaruar  
nuk fal asnjërin nga të dy; ashtu si një hallkë e argjendtë,  
varur në ajër me një spango, të bie pashpjegueshëm në sup.

Të tjerët ranë - fatosa të vërtetë (por, kushedi,  
me sa hidhërim, me sa frikë edhe ata). Nuk ua lakmova vdekjen.  
Nëse u lëvdova heroizmin, e bëra për të mbuluar  
mirënjohjen time të fshehtë që mbeta gjallë - aspak hero.

Ja, pra, që as këtë hare nuk ta dhashë - lavdinë e shumëpërmendur, sikundër thonë,  
e që mbase edhe do të mundte, medet, të blinte  
me monedha gjëmimtare dhe të rreme, dhjetë motet tona të vërteta, motet e heshtjes,  
me mijëra vrasje, të fshehta e të shpallura, me mijëra gabime dhe varre.

Larg nga unë kësi heroizmesh; - një tjetër heroizëm, tanimë,  
i pazhurmë dhe i padukshëm po më grish. Një muzg,  
pashë një nga të tejmet gjethe të allta në një pemë krejt të zezë  
dhe ishte supi i zhveshur i një atleti të qetë e të hijshëm, që, duke u prirë,  
ngriti gjithë barrën tonë, për ta ulur lehtazi përdhe. Atëherë  
një uri e re, një tjetër babëzi ma mbushi gojën me jargë  
dhe ndjeva të më rridhte nga cepat e buzëve  
i ëmbël dhe çlodhës qumështi i mirënjohjes. Padashur  
ngrita dorën deri lart për ta fshirë,  
që të mos tradhtohesha, që të mos ma shihnin atë foshnjëri të re,